



## BULETIN

3 – MUJOR/NR. 15  
JANAR – MARS 2006

### PASQYRA E TITUJVE KRYESORË :

1. VËZHGIME TË KSHH-SË – fq 2
2. VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE OFRIM  
EKSPERTIZE LIGJORE – fq 2
  - Gjykata kushtetuese e KSHH-se
  - Ofrim ekspertize & oponenca ligjore
  - Ngritje kapacitetesh administrata  
publike
3. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE &  
EDUKUESE – fq 6
4. PROJEKTE TË REJA - fq 9
5. PUBLIKIME TË KSHH-SË – fq 9
6. TRYEZA DHE KONFERENCA – fq 10
7. SHETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË – fq  
11
8. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË – fq 13
9. KOMUNIKIME ME AUTORITETE  
SHETËRORE & ORGANIZATA – fq 13
10. KSHH & MEDIA – fq 13
11. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I  
ORGANIZATËS – fq 13

Përgatiti buletin: av. *Etilda SALIU*

Redaktimi letrar: *Maria MATO*

# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## BULETIN

Nr. 15

JANAR – MARS 2006

*Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbeshetjen financiare të CORDAID “CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT”*

### **Vetvlerësimi i organizatës**

Në kuadër të forcimit organizativ dhe hartimit të strategjisë të re për periudhën 2007-2010, gjatë muajit janar 2006, KSHH realizoi një vetvlerësim të punës së organizatës. Në këtë proces vetvlerësimi u angazhua gjithë stafi i KSHH-së dhe ai u asistua nga një ekspert hollandez.

Qëllimi i vetvlerësimit ishte përmirësimi i punës së organizatës nëpërmjet vënies në pah të pikave të forta dhe të dobëta të organizatës, analizës së situatës së të drejtave të njeriut në të cilën vepron organizata, analizës së burimeve njerëzore, vizionit, vlerave të tyre, krahasimit të rezultateve të veprimtarisë me burimet e përdorura, vënia në pah e vështirësive në punën e organizatës shoqëruar me rekomandimet përkatëse për kapërcimin e tyre dhe përmirësimin e punës në të ardhmen.

*Vazhdon në faqen 13*

### ***Lufta kundër korrupsionit dhe nepotizmit nuk legjitimohet duke shkelur kushtetutën & të drejtat e njeriut***

Në datën 10 shkurt 2006, Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra e Studimeve Parlamentare, si një Aleancë për të Drejtat Njeriut i dërguan Gjykatës Kushtetuese kërkesën me objekt:

***Shfuqizimin e tre vendimeve të Këshillit të Ministrave me nr. 43 , 44 dhe 48 te dates 27.01.2006, duke konsideruar se ato çenojnë të drejtat themelore të njeriut, duke mos respektuar parimet kushtetuese.***

*Vazhdon ne faqen 2*

*Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:*

### **KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**

Rr: Gjijn Bue Shpata; Pall. 5/1,  
Ap.4, Tiranë, P.O Box nr. 1752  
web site: [www.abc.org.al](http://www.abc.org.al)

Tel: 04 233671  
CEL: 068 20 23699;  
E mail: [office@abc.org.al](mailto:office@abc.org.al)

## 1. VËZHGIME

### 1.1 Respektimi i të drejtave të të paraburgosurve dhe të të dënuarve në disa burgje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, gjatë muajve *shkurt-mars 2006*, në institucionet e riedukimit në Krujë, Lezhë, Peqin, Burrel dhe Rrogozhinë, realizoi misionet vëzhgimi të kryera nga një grup juristësh dhe anëtarësh të asamblesë së KShH-së<sup>1</sup>. Qëllimi i këtyre misioneve ishte vëzhgimi i respektimit të të drejtave të personave që vuajnë dënimin në këto institucione si dhe i punës së personelit të administratës.

Vëzhguesit konstatuan probleme të tilla, si: mosrealizimin e normës së ushqimit të të dënuarve, mbipopullimin e disa burgjeve, qëndrimin dhe rregullimin e tyre në mjediset në burg, transferimin e personave me të meta mendore në institucione të posaçme për ta, mungesën e punësimit të të dënuarve në burgje, mungesën e literaturës së re dhe të nevojshme në bibliotekat e këtyre institucioneve si edhe çështje të tjera që vijnë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Në përfundim të këtyre misioneve të vëzhgimit, nëpërmjet një letre drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, KShH-ja dha disa rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës së të drejtave të të dënuarve, të kushteve të jetesës në këto burgje, të legjislacionit përkatës dhe praktikës si edhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale në administratën e këtyre institucioneve.

### 1.2 Respektimi i të drejtave të emigrantëve shqiptarë në pikat e kalimit të kufirit<sup>2</sup>

Gjatë muajit janar 2006, KShH-ja realizoi disa misionet vëzhgimi edhe në pikat e kalimit të kufirit me shtetet fqinje. Raundi i vëzhgimeve ishte në vijim të atyre të realizuara në fund të vitit 2005, në periudhën kur edhe fluksi i lëvizjeve të emigrantëve shqiptarë është i madh.

Synimi i këtyre vëzhgimeve ishte njohja e respektimit të të drejtave të emigrantëve dhe e respektimit të procedurave nga forcat e policisë kufitare shqiptare dhe asaj greke. U realizuan takime me krerët e policisë kufitare (shqiptarë ose grekë) dhe kapitenerisë (porti i Vlorës), takime me emigrantë etj.

Realizimi i këtyre misioneve ndihmoi në pasurimin e informacionit të KShH-së lidhur me trajtimin e emigrantëve shqiptarë nga policia greke dhe ajo shqiptare, si dhe në krijimin e urave të bashkëpunimit me autoritetet kufitare qendrore dhe lokale për të pasur një respektim më të mirë të të drejtave të shqiptarëve gjatë kalimit të pikave të kufirit. Vëzhgimet u realizuan nga korrespondentët e KShH-së në pikat e kalimit të kufirit të Kakavijës, Kapshticës dhe portit të Vlorës.

## 1. OFRIM EKSPERTIZË NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT DHE TË ZBATIMIT TË TIJ

### 2.1 Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Vëzhgimet u kryen në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri-Monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe në vendet e paraburgimit, rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike, njohja e tyre me të drejtat e njeriut si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë”, i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

<sup>2</sup> Vëzhgimet u kryen në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve nga policia kufitare shqiptare dhe greke”, mbështetur financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

Në datën 10 shkurt 2006, së bashku me Avokatin e Popullit dhe Grupin Shqiptar të të Drejtave të Njeriut, KShH-ja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin si antikushtetuese të tri vendimeve të Këshillit të Ministrave: vendimit nr.43, datë 27.1.2006, “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimit të pushtetit në rekrutim dhe karrierën e personelit të administratës tatimore”; vendimit nr.44, datë 27.1.2006, “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike” dhe vendimit nr. 48, datë 27.1.2006, “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.205, datë 23/4/1999”.

Në këto vendime ndalohet pranimi në punë i personave që kanë lidhje familjare, gjinie apo krushqie me Presidentin e Republikës dhe stafin e tij politik, kryeministrin, zëvendëskryeministrin, ministrat dhe zëvendësministrat, anëtarët e stafit politik të kryeministrit dhe të ministrit të Financave, deputetët, Avokatin e Popullit, komisionet e larta të shtetit etj.

Në vendimet e mësipërme parashikohet, gjithashtu, edhe largimi nga puna në sektorët e doganave dhe të tatimeve të personave që janë punësuar, por që rezulton se janë në marrëdhënie familjare, gjinie ose krushqie me persona që janë në funksionet e përmendura më lart. Arsyet kryesore që paraqiten në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese janë:

- a) cenimi i së drejtës së punësimit;
- b) cenimi i parimit të barazisë para ligjit (diskriminimi);
- c) cenimi i nenit 17 të Kushtetutës, që parashtron kufizimin e të drejtave të shtetasve vetëm me ligje të miratuara nga Kuvendi;
- d) cenimi i ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, që garanton profesionalizmin dhe karrierën në punë, ku përcaktohen kriteret për marrjen në punë dhe largimin nga puna.

Para se qeveria të miratonte vendimet e Këshillit të Ministrave, nëpërmjet një deklarate për shtyp, KShH-ja i sugjeroi qeverisë të mos miratonte vendimet, sepse ato vinin në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, por ky sugjerim nuk u mor parasysh.

Më 21 mars të këtij viti u zhvillua seanca dëgjimore në Gjykatën Kushtetuese ku u dhanë argumentet ligjore të përfaqësuesve ligjorë të Këshillit të Ministrave, të KShH-së dhe të Avokatit të Popullit. Në këtë seancë, Gjykata Kushtetuese mori vendimin e ndërmjetëm për pezullimin e zbatimit të vendimeve të Këshillit të Ministrave, nr.43, 44 dhe 48, duke i cilësuar ato si vendime që cenonin të drejtat e njeriut.

Të paditësh qeverinë në Gjykatën Kushtetuese nuk do të thotë t’i kundërvihesh qëllimeve të saj të mira për luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit në administratën publike shqiptare, por kjo luftë duhet të jetë brenda kornizave të njohura të respektimit të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të njohura nga Kushtetuta shqiptare dhe nga aktet ndërkombëtare.

## ***2.2 Ofrim ekspertize dhe oponenca ligjore***

### **2.2.1 Ekspertizë ligjore për projektligjin “Për moratoriumin e mjeteve lundruese”<sup>4</sup>**

---

<sup>3</sup> Mbështetur nga “Ngritja e kapaciteteve të organizatës dhe forcimi i organizimit të brendshëm”, CORDAID.

<sup>4</sup> Ekspertiza është ofruar në kuadër të “Ngritjes së kapaciteteve të organizatës dhe forcimit të organizimit të brendshëm”, financuar nga CORDAID-i.

Më 15 shkurt të këtij viti, nëpërmjet një letre drejtuar Komisionit për Çështje Ligjore, si dhe për Çështje të Administratës Publike dhe të Drejtave e Njeriut, KShH-ja dha rekomadimin e vet për projektligjin i cili ndalon lëvizjen e skafeve dhe të mjeteve lundruese në bregdetin shqiptar, për një hark kohor prej 3 vjetësh.

KShH-ja vë në dyshim nëse kufizimi i së drejtës është në përpjesëtim me qëllimin që kërkon të arrijë dhe nevojën e diktuar. Tashmë ky ligj ka hyrë në fuqi.

### **2.2.2 Ekspertizë ligjore për projektligjin “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”<sup>5</sup>**

Gjatë muajit shkurt, KShH-ja ofroi ekspertizën e vet për projektligjin “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”.

Në bazë të projektligjit të paraqitur, ligjit "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror" i është bërë një shtesë sipas së cilës parashikohet edhe "informacioni i kufizuar" kur "eksponimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme veprimtarisë normale të shtetit dhe interesave apo efektivitetit të institucioneve shtetërore".

Pas studimit të këtij projektligji, KShH-ja vlerësoi se shtesa që mendohej t'i bëhej nenit 3 të ligjit nr. 8457, është serioze, mjaft e diskutueshme dhe mund të sjellë një kufizim të pajustificuar të së drejtës kushtetuese të informimit. Tashmë ligji është miratuar nga Kuvendi dhe është dekretuar nga Presidenti.

### **2.2.3 Oponenca për projektligjin "Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit"<sup>6</sup>**

Gjatë muajit mars 2006, KShH-ja u njoh me projektligjin “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”. Pas studimit të këtij projektligji, KShH-ja vlerësoi se ai kishte pasaktësi dhe boshllëqe që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mund të cenonin interesat e ligjshëm të shtetasve dhe besueshmërinë e autoritetit shtetëror që do të ngarkohet me zbatimin e këtij ligji.

Disa nga pikat më të diskutueshme të projektligjit ishin: *mospërcaktimi në mënyrë të qartë i mekanizmit që do të realizojë pranimin dhe shqyrtimin e denoncimeve, i personit ose i organit që do të ketë kompetencën e vendimmarrjes*, d.m.th. atë të nismës së procedimit administrativo-civil si edhe të kallëzimit në organet e ndjekjes penale; *procedurat që ndiqen në rastin kur denoncimi bëhet me gojë ose në mënyrë anonime; ruajtja e konfidencialitetit të denoncimit*, si për përmbajtjen tij, ashtu edhe të autorit që ka realizuar denoncimin; *rastet kur denoncimet përmbajnë elemente të veprës penale dhe procedurat që do të ndiqen për vënien në lëvizje të prokurorisë; procedurat që mund të ndiqen gjatë hetimit administrativ ose penal të çështjes etj.*

### **2.2.4 Oponencë ligjore për projektvendimin “Për punësimin e të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit”**

Gjatë muajit shkurt, KShH-ja ofroi edhe një ekspertizë ligjore për projektvendimin e Këshillit të Ministrave për zhvillimin e aktivitetit të punës së të dënuarve në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale me punësimin e të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit.

KShH-ja e vlerësoi nismën për hartimin e këtij projektvendimi pasi punësimi i të dënuarve është shumë i nevojshëm për përmirësimin e jetesës së tyre në kushtet e vuajtjes së dënimit në

<sup>5</sup> Ekspertiza është ofruar në kuadër të “Ngritjes së kapaciteteve të organizatës dhe forcimit të organizimit të brendshëm”, financuar nga CORDAID-i.

<sup>6</sup> Ekspertiza është ofruar në kuadër të “Ngritjes së kapaciteteve të organizatës dhe forcimit të organizimit të brendshëm”, financuar nga CORDAID-i.

institucionet e riedukimit dhe riintegrimin e tyre në shoqëri pas përfundimit të vuajtjes së dënimit. Për të diskutuar më shumë rreth kësaj çështjeje, KShH-ja organizoi më vonë një tryezë të rumbullakët.

### **2.2.5 Ekspertizë ligjore në monitorimin e strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom” (veprimtari në vazhdim)**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në bashkëpunim me fondacionin SOROS (OSFA), është angazhuar në dhënien e ekspertizës për zbatimin e strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”. Qëllimi i kësaj ekspertize është monitorimi i kushteve të jetesës së minoritetit rom në fushat kryesore ku është përqendruar strategjia kombëtare e këtij minoriteti, përkatësisht në fushën e arsimit dhe të edukimit, të trashëgimisë kulturore dhe familjare, të ekonomisë dhe të mbrojtës sociale, të shëndetësisë dhe të infrastrukturës si dhe të drejtësisë dhe të administratës publike. Studimi i minoritetit rom është shtrirë në 5 qytete kryesore, përkatësisht në Tiranë, Fier, Korçë, Elbasan dhe Shkodër.

Raporti i përgatitur synon evidentimin e fakteve dhe të të dhënave konkrete lidhur me zbatimin e objektivave dhe masave përparësore të përcaktuara në strategjinë kombëtare, ndërgjegjësimin e strukturave përkatëse shtetërore për marrjen e hapave të duhur në këtë fushë, sensibilizimin e opinionit rom në përgjithësi dhe të organizatave përfaqësuese të këtij minoriteti për domosdoshmërinë e bashkëpunimit të tyre për realizimin e këtyre objektivave si dhe hartimin e rekomandimeve konkrete për organet shtetërore<sup>7</sup>.

### **2.2.6 Ekspertizë për situatën e sistemit të drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri<sup>8</sup>**

Në datat 10 dhe 11 prill të këtij viti, KShH-ja u ftua për të dhënë ndihmesën e vet në tryezën e rumbullakët “Masat alternative për të miturit”, organizuar nga UNICEF-i, Ministria e Drejtësisë, Terre des Homme, Delegacioni Europian dhe SIDA. Në këtë tryezë KShH-ja paraqiti një raport për situatën e sistemit të drejtësisë të të miturve në Shqipëri dhe për zbatimin e masave alternative të dënimit me burgim duke dhënë një pasqyrë të mangësive të legjislacionit shqiptar lidhur me përmbajtjen e masave alternative dhe vështirësive të zbatimit të tyre në praktikë. Në fund të diskutimit, KShH-ja dha edhe rekomandimet e veta.

## **2.3 Ngritje kapacitetesh dhe veprimtari trajnuese**

### **2.3.1 Ofrim asistence teknike - Sesioni i tretë i punës me administratën e burgut të Lezhës<sup>9</sup>**

Në kuadër të rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit të administratës së burgjeve dhe të njohjes me të drejtat e njeriut dhe të zbatimit të ligjeve, në datat 23-24 shkurt 2006, KShH-ja organizoi sesionin e tretë të punës me administratën e burgut të Lezhës. Grupet synuese të këtij sesioni ishin niveli drejtues, shefat e sektorëve dhe personeli me uniformë i këtij burgu. Objektivat kryesorë të sesionit ishin rritja e kapaciteteve profesionale të personelit lidhur me trajtimin e të dënuarve, për

<sup>7</sup> Ky studim bëhet në kuadër të projektit të mbështetur financiarisht nga fondacioni SOROS.

<sup>8</sup> Ekspertiza është ofruar në kuadër të “Ngritjes së kapaciteteve të organizatës dhe forcimit të organizimit të brendshëm”, financuar nga CORDAID-i.

<sup>9</sup> Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit të KShH-së “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri- Monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit, rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike, njohja e tyre me të drejtat e njeriut si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë”, i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

respektimin më të mirë të të drejtave të tyre me qëllim sigurimin e një trajtimi njerëzor të të dënuarve. Në këtë sesion ofroi ekspertizën e tij edhe eksperti holandez Jan van den Brand <sup>10</sup>.

Ky sesion u përqendrua në disa çështje të rëndësishme lidhur me menaxhimin e burgjeve, të tilla si: konceptet dhe kushtet kryesore për trajtimin e të dënuarve nga i gjithë personeli i burgjeve, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare; kategorizimi i të dënuarve; përcaktimi i trajtimit të duhur të tyre në programin ditor; rregulloret për ngjarjet e paparashikuara/incidentet; funksionimi i mekanizmit të kërkesë-ankesës në burgje si edhe e drejta e të dënuarve për të pasur korrespondencë të lirë. Gjithashtu, në këtë sesion u zhvillua edhe një diskutim për thithjen e sugjerimeve mbi politikat që inkurajojnë punësimin e të dënuarve në burgje.

KShH-ja i prezantoi administratës së këtij burgju dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve disa nga rekomandimet përkatëse, bazuar në tematikën e diskutuar në këtë sesion pune.

### **2.3.2 Këshillime ligjore ofruar administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve<sup>11</sup>**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit edhe këtë vit po vazhdon ofrimin e këshillimeve Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me reformat në burgje, parë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut.

Duke filluar nga janari i vitit 2005, KShH-ja u ka ofruar seanca këshillimore drejtuesve të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) për çështje shumë të rëndësishme në kuadër të reformimit të këtij institucioni. Këto seanca këshillimore janë bazuar në nevojat e DPB-së nga këndvështrimi i standardeve ndërkombëtare dhe i të drejtave të njeriut.

KShH-ja ka ofruar seanca këshillimore për çështje, si: punësimi i të dënuarve në burgjet shqiptare, kuadri nënligjor dhe format e organizimit të tij në praktikë në një të ardhme të afërt, si dhe sanksionet alternative në burg.

## **3. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE**

### **3.1 Festival i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri<sup>12</sup>**

Në datat 16-18 mars 2006, në mjediset e Marubi Film & Multimedia School, për herë të parë u zhvillua Festivali i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri.

Festivali i Filmit për të Drejtat e Njeriut ishte nismë e shkollës së filmit dhe të multimedias "MARUBI", realizuar në bashkëpunim me International Human Rights Education Consortium, Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Utica College, UNICEF-in, Grupin Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, ambasadën amerikane në Shqipëri dhe Institutin Shqiptar të Medias.

Aktivitetet kryesore të këtij festivali ishin shfaqja e disa filmave, ndërmjet të cilëve edhe filma me metrazh të shkurtër që trajtonin tema për të drejtat e të miturve, shfrytëzimin e tyre në punë, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e minoriteteve, dënimin me vdekje, realitete të ndryshme jete krahasuar me vendet e Ballkanit etj.

Qëllimi kryesor i këtij aktivitetit ishte rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe institucioneve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe grupeve të dobëta në veçanti.

<sup>10</sup> Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë në Agjencinë Kombëtare Holandeze të Institucioneve të Riedukimit dhe, në të njëjtën kohë, ekspert i Këshillit të Europës për Europën Qendrore dhe Lindore.

<sup>11</sup> Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit të KShH-së "Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri- Monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit, rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike, njohja e tyre me të drejtat e njeriut si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë", i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

<sup>12</sup> Festivali i Filmit u zhvillua në kuadër të "Ngritjes së kapaciteteve të organizatës dhe forcimit të organizimit të brendshëm", financuar nga CORDAID-i.

*Festivali i Filmit për të Drejtat e Njeriut është fillimi i një tradite e cila do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.*

### **3.2 Sensibilizimi i qytetarëve nëpërmjet artit**

Në kuadër të muajit të historisë së afrikano-amerikanëve, më 23 shkurt 2006, ambasada amerikane, në bashkëpunim me shkollën e filmit dhe të multimedias “MARUBI” dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit, organizuan shfaqjen e filmit "Malcolm X"<sup>13</sup>. Aktiviteti u zhvillua në mjediset e shkollës “Marubi”. Në këtë aktivitet ishin ftuar përfaqësues të shoqërisë civile, të institucioneve shtetërore, të ambasadave, studentë të Fakultetit të Drejtësisë dhe të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Duke treguar historinë e jetës së një djali afrikano-juqor, filmi transmetonte luftën dhe sakrificat e kësaj race me ngjyrë ndaj diskriminimit që ndeshnin nga pjesa e popullsisë së bardhë për sa i përket racës dhe fesë.

Pas filmit, pjesëmarrësit diskutuan për të drejtat e njeriut, veçanërisht për të drejtat e minoriteteve. Ky aktivitet u zhvillua me studentë të Fakultetit të Drejtësisë dhe të Shkencave sociale, Universiteti i Tiranës.

### **3.3 Fushata për sensibilizimin, në “Javën kundër diskriminimit”**

Në datat 21 – 24 mars të këtij viti, në javën kundër diskriminimit, KShH-ja mori pjesë në fushatën ndërkombëtare të nisur nga Rrjeti Europian kundër Diskriminimit për Shkak të Racës, Kombësisë, Fashizmit, në mbështetje të emigrantëve dhe të refugjatëve (UNITED), për sensibilizimin e publikut dhe të institucioneve shtetërore lidhur me luftën që duhet bërë kundër diskriminimit në përgjithësi dhe atij racor në veçanti.

Në kuadër të kësaj jave, KShH-ja ndërmori një sërë aktivitete për sensibilizimin e brezit të ri dhe për vënien në dukje të këtyre dukurive negative.

- **Seminar sensibilizues në shkollën 8-vjeçare “Bajram Curri” dhe në shkollën e mesme të përgjithshme “Petro Nini Luarasi”**

Në datat 23 dhe 24 mars 2006, KShH-ja organizoi aktivitete sensibilizuese<sup>14</sup> në dy shkolla të Tiranës, në shkollën tetëvjeçare “Bajram Curri” si dhe në shkollën e mesme të përgjithshme “Petro Nini Luarasi”. Në të dyja shkollat u zhvillua një konkurs për krijimin më të mirë në prozë, poezi dhe pikturë, me moton: “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”. Për vlerësimin e këtyre krijimeve u ngrit edhe një juri me emra të mirënjohur në fushën e artit, z.Dhimitër Xhuvani dhe z.Xhevahir Spahiu. Për krijimet më të mira, KShH-ja dhuroi libra artistikë nga autorë të mirënjohur shqiptarë.

Në këto shkolla u mbajt dhe seminari me temë: “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”, ku u trajtuan çështje të diskriminimit në përgjithësi, të drejtat e fëmijëve dhe rastet e diskriminimit të tyre, të drejtat e minoriteteve, kryesisht të minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian në veçanti, probleme të diskriminimit kundrejt tyre, paraqitja e disa rezultateve të raportit të KShH-së lidhur me arsimin e minoritetit rom, trashëgiminë kulturore etj. Bibliotekave të këtyre shkollave KShH-ja u dhuroi disa nga publikimet e veta më të fundit.

<sup>13</sup> Aktiviteti u zhvillua në kuadër të “Ngritjes së kapaciteteve të organizatës dhe forcimit të organizimit të brendshëm”, financuar nga CORDAID-i.

<sup>14</sup> Në datën 23 mars 2006 aktivitetet në kuadër të javës kundër diskriminimit u zhvilluan në shkollën e mesme të përgjithshme “Petro Nini Luarasi” dhe në Fakultetin e Drejtësisë dhe të Shkencave Sociale, ndërsa, më 24 mars, ato u zhvilluan në shkollën tetëvjeçare “Bajram Curri”.

- **Seminar me studentë të Fakultetit të Drejtësisë dhe të Shkencave Sociale**

Më 23 mars të këtij viti, në auditorin e Fakultetit të Drejtësisë<sup>15</sup>, u organizua një seminar me studentë të Drejtësisë dhe të Shkencave Sociale. Në këtë seminar u trajtuan çështje të diskriminimit, parë nga këndvështrimi i Konventës Europiane, çështje të diskriminimit në punë. KShH-ja ofroi publikimet e veta për të drejtat e njeriut si dhe dhuroi një sërë nga këto publikime për pasurimin e bibliotekave të shkollave dhe të fakultetit ku u zhvilluan seminarët.

- **Artikuj dhe publikime sensibilizuese**

Gjatë javës, aktivitetet kundër diskriminimit vazhduan me dy shkrime në media<sup>16</sup>, ku paraqiteshin rekomandimet e ECRI-t për shtetin shqiptar për minoritetin rom si dhe disa nga përfundimet e studimit të KShH-së për gjendjen e minoritetit rom në Shqipëri, parë në disa këndvështrime, si: për zbatimin e strategjisë për romët nga ana e shtetit shqiptar, situatën arsimore të tyre, familjen, kulturën dhe traditat, integrimin e rinisë në shoqërinë shqiptare, aktivitetet sportive, rolin e medias etj.

Gjithashtu, në kuadër të javës kundër diskriminimit, KShH-ja nxori edhe një buletin nr. ekstra me rezultatet e punës së disa studentëve të Fakultetit të Drejtësisë të cilët kryen vëzhgime dhe takime me përfaqësues të minoritetit rom.

- **Takime me studentë të Fakultetit të Drejtësisë**

Në kuadër të rritjes së numrit të aktivistëve të të drejtave të njeriut, KShH-ja organizoi një takim me studentët aktivistë të kësaj organizate, të cilëve u dha certifikata dhe nga një fjalor anglisht – shqip të termave juridikë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i kushton rëndësi rritjes së kapaciteteve të të rinjve në fushën e të drejtave të njeriut.

### **3.4 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendëse, të huaja dhe organizma ndërkombëtarë**

- Gjatë kësaj periudhe, përfaqësues të KShH-së kanë marrë takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendëse, të huaja dhe organizma ndërkombëtarë. Konkretisht, janë zhvilluar takime me përfaqësues të: misionit monitorues të BE-së; nënkomisionit për drejtësinë penale të të miturve; delegacionit të Parlamentit finlandez, holandez; delegacionit të CPT-së; projektit të Euraliusit; Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Ministrisë së Jashtme holandeze etj.
- Në kuadër të bashkëpunimit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka zhvilluar një sërë aktivitetesh dhe ka marrë takime me bashkëpunëtorë të ndryshëm. Gjatë muajit mars, përfaqësues të këtij komiteti morën pjesë në takimin e parë të rrjetit të OJF-ve lidhur me emigrantët, në takimin e konsorciumit ndërkombëtar etj.
- Në janar të këtij viti, disa organizata jofitimprurëse të të drejtave të njeriut, ndër të cilat edhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, organizuan një takim për aksionin e përbashkët

<sup>15</sup> Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

<sup>16</sup> Më 25 mars 2006, në gazetën “Telegraf” u botua shkrimi për studimet e KShH-së për gjendjen e minoritetit rom në Shqipëri.



qytetar për zgjedhjet vendore të ardhshme. Qëllimi i takimit ishte paraqitja e nismës, veprimtaritë që do të kryhen, format e bashkëpunimit. Përfaqësuesja e KShH-së theksoi se vëzhgimi i ecurisë së reformës elektorale dhe i procesit zgjedhor do të jetë përparësi e këtij komiteti për vitin 2006. Komiteti Shqiptar i Helsinkit mund të ofrojë ekspertizë në përmirësimin e legjislacionit, të japë rekomandime për përmirësimin e tij, të trajtojë vëzhguesit e vet dhe të organizatave të tjera, të bashkëpunojë me OJF-të e tjera dhe median për sensibilizimin e publikut dhe për informimin më të mirë të tij, të marrë pjesë në monitorimin e fushatës elektorale dhe të ditës së votimit, si dhe të japë rekomandime dhe të reagojë publikisht në rastet e shkeljes së të drejtave të shtetasve lidhur me realizimin e së drejtës së votës.

- Gjatë muajit shkurt 2006, përfaqësues të KShH-së organizuan një takim me ekspertin e çështjeve penitenciare në projektin EURALIUS, z. Peeter Naks. Qëllimi i takimit ishte koordinimi i përpjekjeve për të organizuar një tryezë të përbashkët me specialistë të DPB-së dhe ekspertët e KShH-së dhe të EURALIUS -it lidhur me komentet për projektvendimin e punësimit të të dënuarve në burgjet shqiptare dhe përvojat që do të sjellin në këtë drejtim specialistët e huaj të fushës.

## **4. PROJEKTE TË REJA**

### **4.1 Projekti “Monitorimi i ushtrimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”**

KShH-ja ka filluar zbatimin e projektit “Monitorimi i ushtrimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”. Duke qenë një qytet me tri minoritete: maqedon, rom, arumun dhe një komunitet, ai egjiptian, Korça u përzgjedh si qyteti i parë model për zbatimin e projektit.

Qëllimi i këtij projekti është vlerësimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në këtë qytet dhe evidentimi i mundësive për zhvillimin e tyre. Gjithashtu, nëpërmjet tij synohet të rritet pjesëmarrja e minoriteteve në vendimmarrjen vendore dhe të forcohen marrëdhëniet e tyre me pushtetin vendor. Zbatimi i këtij projekti do t’u krijojë mundësi qytetarëve të përfitojnë nga veprimtaria e administratës vendore dhe të propozojnë përmirësimin në politikat e tyre për minoritetet. Në të njëjtën kohë, ai do të ofrojë një mjet për vetëvlerësimin e autoriteteve vendore dhe do të jetë një mënyrë për përmirësimin e kapaciteteve të tyre për problemet e adresuara nga qytetarët.

Për zbatimin e tij, KShH-ja do të bashkëpunojë me qeverisjen vendore dhe konkretisht me këshillin bashkiak të Korçës. Projekti do të bazohet në anketimin e qytetarëve. Gjithëpërfshirja e qytetarëve të bashkisë së Korçës në përgjithësi dhe e përfaqësuesve të minoriteteve në veçanti do të jetë element i rëndësishëm për një vlerësim sa më objektiv të gjendjes së të drejtave të minoriteteve në këtë bashki.

Në fund të zbatimit të projektit do të hartohet një raport i cili do të bazohet në përpunimin e të dhënave që do të dalin nga anketimet e kryera. Në dhjetor të këtij viti do të organizohet edhe një tryezë e rumbullakët ku do të paraqiten përfundimet kryesore të raportit të punuar. Në këtë tryezë do të jenë të ftuar aktorë të ndryshëm të bashkisë së Korçës.

Kjo përvojë e parë në bashkinë e Korçës mendohet të shtrihet edhe në qytete të tjera të Shqipërisë ku ka minoritete dhe komunitete.

Projekti po realizohet me mbështetjen financiare të Friedrich Ebert Stiftung.

## **5. PUBLIKIMET E KSHH-SË**

- **Raporti i të drejtave të njeriut, 1997 – 2003**

KShH-ja publikoi “Raportin e të drejtave të njeriut në Shqipëri gjatë periudhës 1997-2003”, i cili përshkruan situatën e të drejtave të njeriut në disa nga fushat kryesore gjatë periudhës 1997 – 2003 dhe reflekton momente të veçanta pas kësaj periudhe (gjatë periudhës së përgatitjes për botim të librit). Qëllimi i këtij botimi është të sjellë tek publiku momente të rëndësishme të zhvillimit të shtetit të së drejtës, të demokracisë dhe të respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, të reflektojë përmirësimin e respektimit të të drejtave të shtetasve, por edhe të krijojë një traditë në analizën e gjendjes së të drejtave të njeriut nga vetë organizatat vendëse të të drejtave të njeriut.

#### ▪ **Raporti për gjendjen e medias së minoriteteve në Shqipëri**

Gjatë muajit shkurt, KShH-ja u angazhua në hartimin e raportit për gjendjen e medias së minoriteteve në Shqipëri. Raporti është paraqitur pranë organizatës **South East Europe Media Organisation (SEEMO)**. Ai do të jetë pjesë e një manuali rajonal për median e minoriteteve. Për realizimin e tij, rol të rëndësishëm luajtën korrespondentët e KShH-së në rrethet ku ka minoritete, Korçë, Gjirokastrë dhe Shkodër, të cilët realizuan takime të shumta në lidhje me zhvillimin e medias së minoriteteve. Raporti do të publikohet në muajt në vazhdim.

### **6. TRYEZA DHE KONFERENCA**

#### **6.1 Konferenca për shtyp**

##### **6.1.1 Konferenca në shtyp për padinë e depozituar në Gjykatën Kushtetuese**

Në datën 13 shkurt 2006, KShH-ja, Avokati i Popullit, GSHDNJ-ja dhe QSP-ja dhanë një konferencë shtypi lidhur me padinë e depozituar në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë konferencë ishin të pranishëm gazetarë të disa mediave elektronike dhe asaj të shkruar. Nëpërmjet tyre u bënë të qarta për publikun qëllimi, motivet dhe arsyet që çuan kërkuesit t’i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese për të shpallur antikushtetueshmërinë e vendimeve të Këshillit të Ministrave në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

#### **6.2 Tryeza të rumbullakëta**

##### **6.2.1 Tryezë e rumbullakët për rritjen e ndërgjegjësimit të administratës së burgjeve**

Në kuadër të rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit, të njohjes me të drejtat e njeriut dhe zbatimit të ligjeve nga administrata e burgjeve, në datën 20 janar 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një tryezë të rumbullakët për përmirësimin e mekanizmit të kërkesë-ankesës, masave disiplinore dhe inspektimeve në burgje si edhe për përcaktimin e strategjisë konkrete për zbatimin e rregullave të sjelljes për punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve.

Në këtë tryezë morën pjesë dhe kontribuan me pjesëmarrjen e tyre përfaqësuesit e institucioneve penitenciare në Shqipëri në nivel drejtuesish si edhe përfaqësues me përvojë të KShH-së. Në cilësinë e ekspertit, KShH-ja ftoi ekspertin holandez z.Jan van den Brand. Metodologjia e përdorur në këtë tryezë të rumbullakët ishte interaktive, pasi kishte për qëllim të përballte kuadrin ligjor vendës dhe atë ndërkombëtar me zbatimin e tij në praktikë.

U diskutuan temat e përmendura më sipër, u sollën shembuj teorikë dhe praktikë, të referuar në legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar si dhe u dhanë rekomandime konkrete për përmirësimin dhe zbatimin në mënyrë sa më efektive të ligjeve në praktikë.

## **6.2.2 Tryezë e rrumbullakët me temë: “Politikat kundër korrupsionit dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”**

Në datën 20 mars 2006, në kuadrin e nismave të ndërmarra nga shoqëria civile për rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, disa organizata jofitimprurëse, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e fondacionit SOROS, organizuan tryezën e rrumbullakët me temë: “Politikat kundër korrupsionit dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”<sup>17</sup>. Qëllimi i saj ishte tërheqja e vëmendjes së autoriteteve shtetërore dhe në mënyrë të veçantë e Parlamentit dhe e qeverisë që janë përgjegjës për nismat ligjvënëse, që të vlerësojnë më me kujdes respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në çdo nismë që ndërmarrin, pavarësisht nga objektivat dhe qëllimet.

Theksi i kësaj tryeze u përqendrua në diskutimin e disa nismave ligjore qeveritare të kohëve të fundit, të ndërmarra në kuadrin e politikave kundër korrupsionit, të tilla si: projektligji “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”; vendimet e Këshillit të Ministrave për shmangien e nepotizmit në administratën publike, tatimore dhe doganore; projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” si edhe moratoriumi për mjetet e lundrimit. Pjesëmarrësit në tryezë ishin të mendimit se politikat kundër korrupsionit janë nisma të domosdoshme për zhvillimin e vendit dhe për konsolidimin e demokracisë, të cilat mbështeten nga shoqëria civile dhe shtetasit në përgjithësi, por që nuk duhet të jenë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

## **6.2.3 Tryeza e rrumbullakët me temë: “Prezumimi i pafajësisë dhe roli i medias”**

Në datën 15 mars 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve Parlamentare dhe Forumin e Mendimit të Lirë, organizuan tryezën e rrumbullakët me temë: “Prezumimi i pafajësisë dhe roli i medias”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte të tërhiqte vëmendjen për rëndësinë që ka respektimi i parimit kushtetues të prezumimit të pafajësisë nga ana e medias dhe e aktorëve të tjerë publikë, për ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe të të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Në tryezë u trajtua tema e parimit të prezumimit të pafajësisë, rëndësia e tij dhe pasojat negative që sjell në rastin kur nuk zbatohet sidomos nga media e cila luan rol shumë të rëndësishëm në dhënien e informacionit.

Kjo tryezë kishte si qëllim përmirësimin e terminologjisë së përdorur nga media për pasqyrimin e tij si dhe të gjuhës së përdorur nga politika shqiptare ku parimi i prezumimit të pafajësisë shkelet në mënyrë flagrante.

Disa nga përfundimet e kësaj tryeze ishin: domosdoshmëria e trajtimit të këtij problemi edhe në rrethet e politikanëve në përgjithësi, ndërgjegjësimi i qytetarëve për rolin dhe rëndësinë e institucioneve lidhur me këtë çështje, koordinimi më i mirë ndërmjet Ministrisë së Brendshme, organit të prokurorisë dhe gjykatës, të cilat janë burimet kryesore në dhënien e lajmit.

## **7. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË**

### **7.1 Ankesat**

Gjatë muajve janar – mars 2006, KSHH-ja ka trajtuar **77 ankesa dhe letra**. Objekti i tyre është i ndryshëm, si: vendime të padrejta gjyqësore dhe kërkesa për rishikim të tyre, ankesa për


<sup>17</sup> Ky aktivitet u zhvillua nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, Qendra për Studime Parlamentare, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në bashkëpunimin dhe me mbështetjen e fondacionit “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”, Soros.

ushtrim dhune nga forcat e Policisë të Shtetit, shkelje të të drejtave nga administrata e burgjeve, kërkesa për transferime në institucione të tjera të vuajtjes së dënimit, kërkesa për këshillime ligjore dhe avokat falas etj.

Ankesat janë marrë nga takimet në zyrë me juristë të KShH-së, nëpërmjet letrave drejtuar në adresën e KShH-së, këshillimeve ligjore etj.

KShH-ja u ka kthyer përgjigje qytetarëve duke u dhënë këshillimin përkatës si dhe u ka kërkuar autoriteteve shtetërore të ndërhyjnë për të zgjidhur çështjet konkrete.

*Paraqitja grafike e ankesave:*



## 7.2 Raste të verifikuara nga KShH-ja

Përveç trajtimit të letrave dhe të ankesave të qytetarëve, KShH-ja ka verifikuar raste në të cilat pretendohet se ka pasur shkelje flagrante të të drejtave të njeriut.

- Në datën **18 – 20 shkurt 2006**, në bazë të sinjalizimeve nga qytetarë, KshH-ja, nëpërmjet korrespondentit të tij, realizoi një mision verifikimi për vdekjen e pacientit Gj. S., në spitalin rajonal psikiatrik të Vlorës. Qëllimi i verifikimit ishte mosbërja e autopsisë së pacientit si dhe kushtet në të cilat ai jetonte në spital. Shkaku i vdekjes së tij ka qenë infarkti i miokardit, diagnozë kjo e pranuar nga mjeku. Gjatë verifikimit rezultoi se autopsia nuk ishte bërë edhe për 15 pacientë të tjerë. Për këtë rast të verifikuar iu dërgua shkresë zyrtare ministrit të Shëndetësisë si dhe drejtorisë së spitalit psikiatrik të cilët reagues me përgjigje shkresore për verifikimin e bërë nga KShH-ja.

- Gjatë muajit **mars 2006**, pas sinjalizimeve të marra nga media e shkruar dhe ajo elektronike, KShH-ja, nëpërmjet korrespondentes të tij, verifikoi një rast në rrethin e Gjirokastrës.

Qytetari S.M. nga Tepelena, i akuzuar për vjedhje, kur ishte paraqitur në sallën e gjyqit për të marrë masën e sigurisë, kishte shenja dhe plagë të dukshme dhune. Ky nuk është rasti i vetëm kur të pandehurit ankohen për ushtrim dhune dhe keqtrajtim nga ana e policisë. Korrespondentja e KShH-së verifikoi rastin në fjalë duke marrë takime edhe me shefin e policisë, kancelaren e gjykatës së rrethit gjyqësor të Gjirokastrës si dhe kryeprokurorin e rrethit. Shenjat e dhunës kanë qenë të dukshme, por ky rast i ka kaluar prokurorisë për verifikim.

## 8. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË

Gjatë periudhës janar – mars 2006, KShH-ja, nëpërmjet **14 deklaratave publike dhe 3 njoftimeve për shtyp**, ka reagu për disa çështje, si: reformën zgjedhore, cenimin e së drejtës së shtetasve për punësim dhe largimin e paligjshëm të tyre nga detyra, të dënuarit me probleme shëndetësore, luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit, dhunën e policisë ndaj përfaqësuesve të medias etj.<sup>18</sup>. Duke ngritur zërin në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut, nëpërmjet deklaratave publike, KShH-ja shërben kështu si opozitë konstruktive.

## 9. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHETËRORE DHE ORGANIZATA

Gjatë kësaj periudhe KShH-ja ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet shtetërore, kryesisht për trajtimin e ankesave të ardhura në adresë të KShH-së, për paraqitjen e problematikës së dalë nga vëzhgimi, dhënien e rekomandimeve të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme ligjore dhe praktike etj.

Ka pasur komunikim me institucione, si Kuvendi, Komisioni për Çështjet Ligjore, për çështje që kanë të bëjnë me administratën publike dhe të drejtat e njeriut, me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve etj.

## 10. KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT DHE MEDIA

Aktivitetet e KShH-së të zbatuara gjatë periudhës janar – mars 2006 janë pasqyruar gjerësisht në media, rreth **26 herë**, nëpërmjet shkrimeve, intervistave dhe emisioneve. Edhe deklaratat e KShH-së gjatë kësaj periudhe janë mbuluar rreth **47 herë** nga media e shkruar dhe ajo elektronike. KShH-ja është ftuar në **4 emisione** televizive, ka dhënë **10 intervista, opinione dhe shkrime**. Problemet më të rëndësishme të trajtuara në to kanë qenë: reforma zgjedhore, largimi nga puna i shtetasve, emigrantët shqiptarë në vendet pritëse, reforma në gjyqësor, burgje etj.

## 11. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS

### 11.1 Plani strategjik dhe biznesplani i KShH-së - 2007 - 2010

Në kuadër të forcimit organizativ dhe të hartimit të strategjisë të re për periudhën 2007-2010, gjatë muajit janar 2006 KShH-ja realizoi një vetëvlerësim të punës së organizatës. Në këtë proces vetëvlerësimi u angazhua gjithë stafi i KShH-së, i cili u asistua nga një ekspert holandez. Qëllimi i këtij vetëvlerësimi ishte përmirësimi i punës së organizatës nëpërmjet vënies në pah të pikave të forta dhe të dobëta të organizatës, analizës së situatës së të drejtave të njeriut në të cilën vepron organizata, analizës së burimeve njerëzore, vizionit, vlerave të tyre, krahasimit të rezultateve të veprimtarisë me burimet e përdorura, evidentimit të vështirësive në punën e organizatës, shoqëruar me rekomandimet përkatëse për kapërcimin e tyre dhe për përmirësimin e punës në të ardhmen.

<sup>18</sup> Për më gjerë, shih aneksin nr. 1

*Vlerësimi i organizatës kaloi në dy faza:*

Gjatë fazës së parë u bë vetëvlerësimi i organizatës nga stafi i saj. Metodologjia e përdorur ishte hartimi i një pyetësoi i cili mbulonte çështje që kishin të bënin me punën e organizatës, funksionimin e strukturave të saj, si edhe komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm. Ky pyetësor u hartua në bazë të standardeve të përcaktuara nga Fondacioni Europian për Drejtëm Cilësor.

Gjatë fazës së dytë u bë një monitorim i procesit të vetëvlerësimit dhe një vlerësim i jashtëm i organizatës nga eksperti i jashtëm i cili realizoi takime me stafin, anëtarë të asamblesë dhe të bordit të KShH-së. Ai realizoi edhe një sërë takimesh me përfaqësues të OJF-ve shqiptare, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve shtetërore, bashkëpunëtorë të KShH-së.

Në përfundim të këtij procesi u përgatit një raport nga vetë stafi i KShH-së dhe një raport tjetër do të përgatitet nga eksperti i jashtëm. Ky vetëvlerësim u krye në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve të organizatës dhe forcimi i organizimit të brendshëm”, mundësuar financiarisht nga Organizata Katolike për Ndhimë dhe Zhvillim – CORDAID

## **11.2 NGRITJE KAPACITETESH TË KSHH-SË**

### **▪ TRAJNIME**

1. Në **datat 2-4 shkurt 2006**, Instituti i Shëndetit Publik organizoi një trajnim për shëndetin dhe të drejtat e njeriut. Në këtë trajnim u dhanë disa koncepte kryesore për shëndetin dhe lidhjen e tij me të drejtat e njeriut. Qëllimi final i trajnimit ishte krijimi i një grupi i cili do të vëzhgojë shëndetin dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri, pjesë e të cilit do të jetë edhe KShH-ja. Në këtë trajnim mori pjesë znj.K.Alikaj, juriste/as.administrative
2. Në **datat 27-31 mars 2006**, stafi i KShH-së mori pjesë në një trajnim 5-ditor të organizuar nga vetë KShH-ja, për zhvillimin e planit strategjik dhe të biznesplanit, me mbështjen financiare të CORDAI-it. Në këtë proces KShH-ja u asistua nga z.Klaas Astma.

### **▪ PJESËMARRJA NË AKTIVITETE TË NDRYSHME**

1. Më **27 janar 2006** u organizua Dita e Kujtesës për Viktimat e Periudhës Komuniste, organizuar nga DPB-ja, në formën e një ekspozite. Përfaqësuese e KShH-së në këtë takim ishte znj.E.Papavangjeli.
2. Më **30 janar 2006**, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare organizoi tryezën e rumbullakët "Për një zbatim sa më të mirë të ligjit në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje nga organet e drejtësisë". Përfaqësuese e KShH-së në këtë tryezë ishte znj.K.Alikaj.
3. Më **1 shkurt 2006** u organizua tryeza e rumbullakët për krijimin e koalicionit “Për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në vendimmarrje”, organizuar nga Forumi i Pavarur i Gruas, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe CRCA. Mori pjesë znj.E.Saliu, juriste/koordinatore projekti.
4. Më **2 shkurt 2006** u organizua workshopi kombëtar “Rekomandimet e komitetit kundër torturës lidhur me zbatimin e Konventës Kundër Torturës (CAT) në

Shqipëri”, organizuar nga OJF-të shqiptare: CRCA, GSHDN, QNL, si dhe nga Organizata Botërore Kundër Torturës (OMCT) lidhur me dhunën shtetërore në Shqipëri. Mori pjesë znj.E.Papavangjeli, koordinatorë programesh.

5. Më **3 shkurt 2006** u organizua konferenca për analizën mbi përfaqësimin e gruas dhe situatën politike në fazën paszgjedhore në Shqipëri, organizuar nga Forumi i Pavarur i Gruas. Mori pjesë znj. E.Saliu, juriste/koordinatorë projekti.
6. Më **3 shkurt 2006**, Fondi Kristian i Fëmijëve në Shqipëri (CCF) organizoi një konferencë për prezantimin e projektit 3-vjeçar “Për integrimin dhe fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve romë”. KShH-në e përfaqësoi znj.E. Sefa, juriste/as.projekti
7. Më **3 mars 2006** u organizua takimi i parë për rrjetin e OJF-ve lidhur me emigrantët. Në këtë takim mori pjesë znj.V.Hysi, drejtore ekzekutive.
8. Më **7 mars 2006** u organizua takimi “Qendra e emigrantëve”, organizuar nga IOM-i. Në këtë takim mori pjesë znj. V.Hysi, drejtore ekzekutive.
9. Më **8 mars 2006** u organizua takimi i konsorciumit ndërkombëtar. Në të mori pjesë znj. V.Hysi, drejtore ekzekutive.
10. Më **10 mars 2006** u organizua takimi i nënkomisionit për drejtësinë penale të të miturve. Në të mori pjesë znj. V.Hysi, drejtore ekzekutive.
11. Më **27 mars 2006**, zyra e OSBE-së në Tiranë organizoi një tryezë me temë: “Takim koordinues për çështjet e minoritetit rom”. Përfaqësuesja e KShH-së në këtë takim ishte znj. E.Sefa, juriste/as.projekti.

## ANEKS NR.1 - DEKLARATA

### 1. Dënojmë vrasjen barbare

*Tiranë, më 5 Janar 2005*

**Komiteti Shqiptar i Helsinkit dënon vrasjen në Greqi të 17 vjeçarit me shtetësi shqiptare Edison Jahjas. Kjo ndodhi disa ditë më parë në Rethino të Kretës.**

**KSHH përshëndet me këtë rast veprimet e autoriteteve, greke që vepruan me shpejtësi për ndalimin e personave të implikuar në këtë krim. *Ne do të dëshironim që hetimi i kësaj çështjeje të ishte i drejtë, i gjithanshëm dhe objektiv sepse në këtë drejtim në disa raste hetimi dhe gjykimi i çështjeve me të dëmtuar ose viktima shqiptare, ka qenë i njëanshëm dhe jo transparent në kundërshtim kjo me legjislacionin e brendshëm dhe dokumentat ndërkombëtare.***

KSHH shpreh me këtë rast shqetësimin dhe në të njëjtën kohë edhe keqardhjen e tij të thellë se ende në një vend demokratik dhe anëtar të BE-së siç është Greqia, ***herëpashere shfaqen me egërsi tendencat dhe veprimet ksenofobe dhe raciste me të cilat shpesh nuk është pajtuar as opinion i shëndoshë Grek.***

KSHH shpreh bindjen se kjo ngjarje e veçuar nuk do të ndikojë në cënimin e frymës së mirëkuptimit dhe bashkëpunimit midis dy vendeve tona.

**KSHH gjen rastin t'i drejtohet qeverisë shqiptare që në të ardhmen të tregohet më e vëmendshme në mbrojtje të interesave të ligjshme të shtetasve tanë që punojnë dhe jetojnë në vende të tjera.**

***Mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijëve të vet është detyrë kushtetuese.***

### 2. Largimi i kundraligjshëm nga puna dhe mosekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil për rikthim në detyrë, cënojnë të drejtat e njeriut

*Tiranë, më 9 Janar 2006*

**Në Komitetin Shqiptar të Helsinkit, këto dy muajt e fundit, janë ankuar disa persona me pretendimin se i kishin larguar padrejtësisht nga puna. Ata pretendonin gjithashtu se lidhur me masën disiplinore që ishte marrë ndaj tyre, nuk u ishte dhënë mundësia të jepnin sqarime dhe të mbroheshin.**

KSHH u sugjeroi personave të mësipërm që brenda afatit ligjor të ankoheshin në organet përkatëse. Megjithatë, **KSHH, pavarësisht nga fakti nëse ankesat e tyre ishin ose jo të bazuara, e vlerësoi këtë çështje si një problem që kishte të bënte me respektimin e të drejtave të njeriut.** Pikërisht, për këtë arsye dhe për një informacion më të saktë dhe më të plotë ai iu drejtua **Komisionit të Shërbimit Civil që, siç dihet, është institucion i pavarur i emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe i ngarkuar posaçërisht me zgjidhjen e ankesave të nëpunësve të shërbimit civil.**

**Përfaqësuesit e KSHH-së u njohën me ankesat e paraqitura në këtë Komision dhe rezultoi se gjatë muajit dhjetor, nga 34 vendime të dhëna nga Komisioni i Shërbimit Civil, 30 prej tyre i përkisnin sektorit të doganave, prej të cilëve 19 persona janë larguar me motivacionin për pjesëmarrje në veprimtari politike, pa paraqitur para Komisionit asnjë provë që të vërtetonte se kjo pjesëmarrje binte ndesh me ligjin apo me ndonjë akt nënligjor, ndërsa 4 të tjerë ishin larguar me motivacionin se në zgjedhjet e 3 korrikut të vitit të kaluar, kishin qenë anëtarë në komisionet e qendrave të votimit.**

Komisioni i shërbimit Civil duke mos i gjetur të bazuara largimet nga detyra të rasteve të mësipërme, ka vendosur rikthimin e tyre në punë.

**Përfaqësuesit e KSHH-së u vunë në dijeni gjithashtu se administrata publike kishte refuzuar zbatimin e shumë prej vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil për rikthimin e tyre në punë.**



Edhe pse KSHH nuk paragjykon vendimet e mundshme që mund të jepeshin lidhur me këto çështje nga ana e gjykatës, e shikon të nevojshme të evidentojë faktin **se refuzimi i ekzekutimit të vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil për rikthimin në punë, përbën shkelje të ligjit.**

E themi këtë sepse në nenin 8 pika 3 e ligjit Nr. 8549, dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, thuhet shprehimisht se **“Vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil...janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike vendore dhe qendrore”.**

Për KSHH-në tërheq gjithashtu vëmendje numri relativisht i madh i vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil për rikthimin në detyrën e mëparshme, në raport me çështjet e shqyrtuara dhe të përfunduara.

KSHH, në përfundim, e shikon të nevojshme të theksojë se në rastet e marrjes së masave disiplinore që përmendëm më lart, nuk është mbajtur si duhet parasysh parimi i sanksionuar në nenin 3 të ligjit “Statusi i nëpunësit civil” ku thuhet se: **“Shërbimi civil është ndërtuar dhe vepron mbi bazën e profesionalizmit, të pavarësisë dhe integritetit, të paanësisë politike, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë të karrierës, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi”**, si edhe neni 25 pika 2 e ligjit “Statusi i nëpunësit civil” që në këto raste kërkon nga administrata publike që t’i garantojë nëpunësit civil ndaj të cilit është menduar të merret masa disiplinore, **të drejtën për t’u informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar.**

Moszbatimi me rigorozitet i dispozitave të mësipërme ligjore, çënon të drejtat e shtetasve gjë që shoqërohet edhe me pasojë të dëmshme.

### **3. Të mos lejohet cënimi i të drejtës së shtetasve për punësim dhe largimi i paligjshëm i tyre nga detyra**

*Tiranë, më 16 Janar 2006*

Këto ditët e fundit në median e shkruar dhe në atë elektronike, u njoftua se së shpejti Këshilli i Ministrave do të miratojë një projekt-vendim që **ndalon familjarët dhe të afërmit e qeveritarëve të sotshëm dhe ish-qeveritarëve që të punojnë në sektorët e doganave, tatimeve dhe prokurimeve publike.**

Ky lajm u konfirmua edhe nga Kryeministri i cili u shpreh se së shpejti qeveria do ta miratojë këtë vendim.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit edhe pse nuk është njohur me brendinë dhe detajet e këtij projekti, **për efekte sensibilizimi dhe parandalimi, vendosi të parashtrijë publikisht objeksionet e mëposhtme:**

- 1. Miratimi i këtij vendimi,** pavarësisht nga qëllimet e mira që ai mund të synonte, **do të cënonte drejtpërdrejtë të drejtat e ligjshme të shtetasve të sanksionuara në nenin 18 të Kushtetutës** ku thuhet se “të gjithë janë të barabartë para ligjit, se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”, **në nenin 49 të Kushtetutës** ku thuhet se: “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”, si edhe në **nenin 107 të Kushtetutës** ku thuhet se: “Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji. Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj”.
- 2. Në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë** thuhet se: “Ndalohet çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit; se “Me diskriminim kuptohet çdo dallim, përjashtim ose parapëlqim që bazohet në racë, ngjyrë, seks, moshë, fe, bindje politike,

origjinë kombëtare, origjinë shoqërore, *lidhje familjare*, të meta fizike ose mendore *që çënon të drejtën e individit për të qenë i barabartë në punësim dhe trajtim*”.

3. KSHH mendon se raste të tilla nuk mund të përfshihen në nocionin e “konfliktit të interesave”. *Interpretimet e zgjeruara dhe subjektive lidhur me konfliktin e interesave do të çënonin rëndë të drejtat e ligjshme të shtetasve dhe si rrjedhim mund të shoqëroheshin me pasoja të dëmshme*. Koncepti i “konfliktit të interesave” është *real dhe jo i supozuar. Ai mbështet në kritere ligjore*.

Për KSHH-në sikur rastet e ndalesave për punësim ose për largim nga detyra që mendohet të miratohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, do të konsideroheshin të ligjshme, e arsyeshme do të ishte që i njëjti kriter të ndiqej edhe për sektorë të tjerë siç mund të ishin: prokuroria, gjykata, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Inspektoriat i Kontrollit dhe Verifikimit të Pasurive të zyrtarëve, etj., që siç dihet janë sektorë të rëndësishëm dhe delikatë.

4. KSHH e sheh të nevojshëm të evidentojë gjithashtu faktin se në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Status i nëpunësit civil” janë përcaktuar *rregullat e pranimit dhe largimit të punonjësit të shërbimit civil* që mbështeten në parimet e profesionalizmit dhe të transparencës, të përgjegjësisë dhe të korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi (neni 3).

Përsa i përket rregullave të etikës në administratën publike *vepron ligji nr. 9131, datë 8.09.2003*. Në këtë ligj bëhet fjalë për konfliktin e interesave (neni 4) si dhe për shmangien e konfliktit të interesave (neni 5).

5. KSHH ka gjithashtu parasysh edhe ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Në këtë ligj jepet përkufizimi i nocionit “konflikt i interesit” (neni 3). Ndërsa në nenin 32 të ligjit të mësipërm bëhet fjalë për përkufizimet *për zyrtarin e organit tatimor ose doganor*. Asnjë ndalesë nuk parashikon kjo dispozitë për marrjen në punë ose për largimin nga detyra të personave që mund të jenë familjarë ose të afërm të zyrtarëve të lartë, të qeveritarëve ose ish-qeveritarëve.

KSHH mendon se përmbajtja e kësaj deklarate mund t’i shërbente rivlerësimit të kësaj çështjeje që ka të bëjë me respektimin e Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi.

*Për arsyet e përmendura më lart, KSHH i sugjeron qeverisë të mos e miratojë vendimin për të cilin bëhet fjalë.*

#### **4. Fajtorët të përgjigjen- Konflikti të parandalohet**

*Tiranë, më 23 Janar 2006*

Sipas të dhënave të medias së shkruar dhe asaj elektronike, banorët e fshatit Nepravishtë (Gjirokastrë) kanë protestuar kundër “Alfa-Glinës” kur kjo e fundit filloi të instalonte tubacionet për tërheqjen e ujit të pijshëm nga burimi i “Vrizit”.

Siç thuhet, nëpërmjet tubacioneve, prej këtej do të merreshin 4-6 litra ujë në sekondë që më vonë do të ambalazhohej. **Sipas banorëve të këtj fshati, kjo ndërhyrje do të dëmtonte rëndë interesat e tyre aq më tepër se është pronë e shtetit dhe për nevoja të domosdoshme duhet të ishte marrë edhe pëlqimi i tyre.**

Forcat e policisë dhe të ndërhyrjes së shpejtë shkuan në vendin e ngjarjes por në vend që ky konflikt të parandalohej **përdorimi i dhunës nga ana e policisë e acaroi edhe më tej gjendjen**. Pamjet filmike të transmetuara nga TV private paraqitën në mënyrë evidente *përdorimin e dhunës mbi banorët që ndodheshin në protestë*, megjithëse drejtuesit e policisë së Gjirokastrës kanë pretenduar se janë banorët që kanë qëlluar mbi forcat e rendit. Në këtë konfrontim, veç deputetit Vangjel Tavo, janë lënduar edhe 4-5 persona të tjerë.

***KSHH reagon ndaj kësaj ngjarjeje që mund dhe duhet të parandalohej, sepse ky konflikt është i hershëm. KSHH reagon gjithashtu sepse disa herë na është dashur të denoncojmë publikisht keqtrajtimin e shtetasve nga punonjësit e policisë.***

**KSHH përshëndet me këtë rast vlerësimin e menjëhershëm të kësaj ngjarjeje nga Ministri i Brendshëm Z. Sokol Olldashi duke urdhëruar sqarimin e saj.**

***KSHH i sugjeron organeve të prokurorisë për hetimin me përparësi, me objektivitet dhe në mënyrë të gjithanshme të kësaj çështjeje.***

Meqë problem i ujit për të cilët banorët e Nepravishtës janë ngritur në protestë është jetike, *i bëjmë thirrje qeverisë dhe organeve të qeverisjes vendore që të udhëzojnë dhe të marrin masat për parandalimin e këtij konflikti që mund të shoqërohet me pasoja të dëmshme.*

KSHH e shikon të nevojshme të evidentojë gjithashtu pretendimet e deputetit Vangjel Tavo dhe kryetarit të komunës, Krenar Kulla se punimet që po kryheshin ishin të paligjshme pasi firma nuk kishte marrë lejen përkatëse ndërkohë që kjo çështje vazhdon të jetë objekt shqyrtimi në Gjykatë.

## **5. Të mos cënohet e drejta e privatësisë**

*Tiranë, më 7 Shkurt 2006*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka ndjekur me vëmendje njoftimet në shtyp lidhur me ankesat e disa punonjësve të shëndetësisë që u kërkohet të firmosin një autorizim për të lejuar autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave *“të mbledhë informacion* dhe të kontrollojë pranë çdo institucioni publik dhe privat *të dhënat personale*, kudo ku ato janë regjistruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është gjithashtu në dijeni se këtë çështje e ndjek edhe Avokati i Popullit, madje ai ka rekomanduar edhe *pezullimin e kërkesës së plotësimi të këtij autorizimi deri në përfundimin e çështjes nga ana e tij.*

Por meqë të njëjtat ankesa i janë drejtuar edhe KSHH-së, pasi u njohëm me materialet përkatëse, parashtojmë objeksionet tona si më poshtë:

*Së pari:* Autorizimi i referohet ligjit nr. 9376 datë 7.IV.2005 “Për shmangjen e konfliktit të interesave”. Në të nuk përmendet dispozita përkatëse e këtij ligji që të detyrojë shefat e shërbimeve të lëshojnë një autorizim të tillë autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.

E shikojmë të nevojshme të theksojmë se autoriteti më i lartë qëndror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektoriat i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive (shih nenin 41), se ai, veç të tjerave, është kompetent të monitorojë, kontrollojë dhe vlerësojë përputhshmërinë e

akteve nënligjore dhe të rregulloreve të brendshme, të miratuara nga institucionet publike për konfliktin e interesave, me parimet dhe detyrimet e këtij ligji të përcaktojë *modelin e deklaramit, si dhe të nxjerrë akte nënligjore në formën e urdhërave dhe udhëzimeve (shih nenin 42).*

KSHH përshëndet me këtë rast vënien në lëvizje lidhur me këtë konflikt të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë *për të verifikuar në vend përmbajtjen e autorizimit që u është shpërndarë shefave të QSUT “Nënë Tereza”.*

*Së dyti:* KSHH konsideron jo të rregullt dhe të pasaktë frazën e përgjithshme të autorizimit që ka të bëjë me mbledhjen e informacionit nëpërmjet kontrolleve pranë çdo institucioni publik dhe privat, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

*Kjo frazë e përgjithshme dhe e pakonkretizuar mund t’i lerë shteg edhe mbledhjes së të dhënave të natyrës private apo personale gjë që bie ndesh me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 8517 datë 22.VII.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në nenin 10 të këtij ligji thuhet se: “Trajtimi i të dhënave personale nga persona të tjerë lejohet vetëm në rast se subjekti i këtyre të dhënave ka dhënë shprehimisht pëlqimin e tij”.*

KSHH mendon se është e nevojshme të përcaktohet çfarë të dhënash personale kërkohen nga ky verifikim.

*KSHH ka bindjen se ky problem do të zgjidhet në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve në fuqi.*

## **6. Deklarate per Shtyp - Lufta kundër korrupsionit dhe nepotizmit nuk legjitimohet duke shkelur Kushtetuten dhe të drejtat e njeriut**

*Tiranë, më 13/02/2006*

Në datën 10 shkurt 2006, Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra e Studimeve Parlamentare, si një Aleancë për të Drejtat Njeriut i dërguan Gjykatës Kushtetuese kërkesën me objekt: *shfuqizimin e tre vendimeve të Këshillit të Ministrave me nr. 43 , 44 dhe 48 te dates 27.01.2006, duke konsideruar se ato çenojnë të drejtat themelore të njeriut, duke mos respektuar parimet kushtetuese.*

**Para miratimit të këtyre vendimeve, KSHH-ja reagoi me nje deklaratë për shtyp nëpërmjet së cilës i sugjeronte qeverisë të mos miratonte vendimet, sepse ato vinin në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, por kjo nuk u mor parasysh.**

Në termat e kontrollit dhe balancës së pushteteve, organizmat e Shoqërisë Civile dhe Institucionet Kushtetuese që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nuk mund të qëndrojnë indiferente dhe ta reduktojnë identitetin e tyre thjesht në dekoracion institucional të pushtetit.

Ne jemi rojtarë publikë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, prandaj nuk mund të qëndrojmë vetëm në fushën e deklaratave, kështu që vendosëm të përdorim të gjitha rrugët institucionale që na lejon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. **Të paditësh Qeverinë në Gjykatën Kushtetuese nuk do të thotë se i kundërvihesh qëllimeve të saj të mira për luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit në administratën publike shqiptare. Ne kemi kërkuar që kjo “luftë apo reformë” të jetë brenda kornizave të njohura të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të njohura nga Kushtetuta shqiptare dhe aktet ndërkombëtare.**

Argumenti kryesor që paraqitet në kërkesën tonë për shpalljen si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme është fakti se sipas nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, **organi kompetent për të vendosur kufizimin e të drejtave të shtetasve të parashikuara në Kushtetutë, është Kuvendi.** Në këtë nen thuhet se **kufizimi** i këtyre të drejtave vendoset **vetëm**

**me ligj.** Kjo do të thotë se *Këshilli i Ministrave nuk ka të drejtë të marrë vendime të tilla që janë te paligjshme, sepse Qeveria ka marrë kompetencat e Parlamentit, dhe si të tilla ato janë automatikisht antikushtetuese.*

Lufta kunder korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk mund të legjitimohet me akte nenligjore, të cilat krijojnë hapesira për një zbatim selektiv dhe joproportional, që do të komprometonte edhe vetë qëllimin e lavderueshem, për të cilin ato janë nxjerre.

Këto vendime shkelin parimin kushtetues të garancive ligjore të nëpunësve, *që mbrohen me ligj, dhe janë në shkelje të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” dhe Kodin e Punës.* Këto janë shkaqe që duhen patur parasysh para fillimit të marrëdhënieve të punës dhe *kurrësi nuk mund t’u jepet fuqi prapavepruese.*

Sipas mendimit tonë, *këto vendime çënojnë edhe parimet Kushtetuese të barazisë para ligjit dhe atë të mosdiskriminimit.* Vendimet e Këshillit të Ministrave *çënojnë gjithashtu edhe të drejtën e shtetasve për punësim dhe garanci për profesionin dhe karrierën e tyre. Këto vendime bien ndesh edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat Njeriut.*

Përveç sa më sipër, ndodhemi në kushtet e një procesi vendimmarrës, duke anashkaluar Kushtetutën dhe pa u konsultuar edhe me grupet e interesuara, shoqërinë civile dhe institucionet e të drejtave të njeriut për të ofruar opionencë për mirëqeverisje përmes ligjeve.

*Nënshkruajnë dekaratën për shtyp:*

Prof.as.dr. **Vasilika HYSI**  
Drejtoresh Ekzekutive  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Prof.as.dr. **Ermir Dobjani**  
Avokati i Popullit

**Elsa Ballauri**  
Drejtoresh Ekzekutive  
Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut

**Sokol Berberi**  
Drejtor Ekzekutiv  
Qendra e Studimeve Parlamentare

## **7. Akuzat e ndërsjella nuk justifikojnë vonesat në përmirësimin e legjislacionit zgjedhor**

*Tiranë, më 15 Shkurt 2006*

**Komiteti Shqiptar i Helsinkit me keqardhje konstaton se qysh nga publikimi i raportit të OSBE/ODIHR-it të 7 Nëntorit 2005 lidhur me zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005, me përjashtim të krijimit të komisionit të posaçëm parlamentar, nuk është hedhur asnjë hap konkret.**

Gati të gjitha forcat politike janë shprehur për zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, por deri më sot ato nuk kanë kaluar kufijtë e deklaratave të përgjithshme.

Partitë e vogla kanë pretendime ndaj dy partive më të mëdha që kërkojnë të dominojnë vendimmarrjen për interesa të ngushta partiake, ndërsa dy partitë më të mëdha për këtë zvarritje vazhdojnë të bëjnë akuza të ndërsjella.

**Për KSHH-në qëndrime të tilla janë vazhde e së kaluarës. Ato janë shprehje e mungesës së vullnetit politik.** Në të gjitha raportet e OSBE/ODIHR-it edhe pse janë bërë rekomandime për

ndryshime në Kodin Zgjedhor vazhdimisht është vënë theksi tek mungesa e vullnetit politik. **Është pikërisht mungesa e këtij vullneti që ka ndikuar negativisht edhe në zgjedhjet e ndershme, si rrjedhim në mosarritjen e standardeve që kërkohen.**

***KSHH e konsideron urgjente vënien sa më shpejt në funksion të komisionit të posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore.***

KSHH është i ndërgjegjshëm për nevojën e intensifikimit të reformave, veçanërisht në disa fusha prioritare. ***Megjithatë, ne mendojmë se reforma në fushën e legjislacionit zgjedhor është e një rëndësie të veçantë.***

Të gjithë pranojnë deformimin e vullnetit të zgjedhjeve për shkak të fenomenit të “Dushkut”. E megjithatë, deri më sot, asgjë konkrete nuk është sugjeruar për parandalimin e tij. Mund të diskutohet për nevojën e ndryshimeve në sistemin zgjedhor, ose për ndërhyrje të tjera në Kushtetutë, **por nëse zvarritet përgatitja për zgjedhjen e organeve të qeverisjes vendore pasojat mund të jenë të dëmshme sepse mund të vihet në pikëpyetje garantimi i zgjedhjeve sipas standardeve ndërkombëtare.**

***Në këtë drejtim KSHH ka parasysh faktin se nuk është e rekomandueshme që në Kodin Zgjedhor të bëhen ndryshime gjatë periudhës 6 mujore para zgjedhjeve.***

**KSHH e shikon të nevojshme t’i bëjë thirrje parlamentit që është organi më i lartë ligjvënës dhe të gjithë partive parlamentare që kanë përfaqësuesit e tyre në komisionin e posaçëm për reformën zgjedhore që me mirëkuptim dhe tolerancë të zgjidhin çështjet që pjesërisht janë të karakterit procedural.**

Elektorati ndjek me vëmendje qëndrimet e çdo partie politike në këtë fushë. Ai është tepër i ndjeshëm dhe nuk pajtohet me vonesa që mund të ndikojnë në ecurinë normale të zgjedhjeve të ardhshme.

***Do të jetë e pafalshme që edhe në zgjedhjet e qeverisjes vendore të konkludohet se zgjedhjet ishin të lira por nuk ishin të ndershme kur dihet se ndershmëria është elementi kryesor i standardeve që kërkohen.***

**8. Dhuna e policisë ndaj shtetasve dhe përfaqësuesve të medias është e patolerueshme dhe e ndëshkueshme**

Tiranë, më 19 shkurt 2006

Pas denoncimit të dhunës së policisë ndaj banorëve të fshatit Nepravisht në rrethin Gjirokastrë, ***një rast tjetër dhune është shënuar ndaj gazetarit të Gazetës Shqiptare dhe televizionit NEWS 24, Gerti Xhaja dhe të atit të tij, më datë 18 shkurt 2006, në qytetin e Lushnjës. Deri më sot, ende nuk janë bërë të ditura publikisht përgjegjësitë e shkaktarëve të dhunës ndaj banorëve të fshatit Nepravisht, ndërsa në rastin e dhunës së ushtruar ndaj gazetarit dhe të atit të tij, është kërkuar hetimi i shpejtë dhe i plotë i përgjegjësve dhe ndëshkimi i tyre.***

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH-ja) nuk paragjykon bazueshmërinë ligjore të kontrollit të ushtruar në lokalitetin e prindit të gazetarit Gerti Xhaja. Por, ***përdorimi i dhunës ndaj tyre në momentin e kontrollit, të shoqërimit për në komisarariat dhe në ambjentet e komisarariatit të policisë Lushnje konsiderohet nga KSHH-ja arbitrare dhe të dënueshme.***

Tërheq vëmendjen pretendimi i gazetarit se ai është keqtrajtuar në prani të shefit të krimeve të komisarariatit të policisë. Për KSHH-në, nëse ky pretendim i mësipërm do të rezultonte i

vërtetë, **qoftë vetëm ky fakt përbën një tregues tepër shqetësues, që përveç të tjerave, ndikon negativisht në besimin e shtetasve ndaj ligjit dhe institucioneve të ngarkuara për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e shtetasve.**

Ka të dhëna që dhuna ndaj shtetasit Gerti Xhaja u ushtrua edhe pasi iu **bë e qartë policies se ai ushtronte profesionin e gazetarit.** Ky fakt e bën edhe **më të rëndë dhe të shëmtuar** aktin e kryer.

Gjatë vitit të kaluar, KShH-ja disa herë ka reaguar ndaj rasteve të tilla të dhunës dhe arrin në përfundimin se në drejtim të respektimit të të drejtave të shtetasve nga ana e policisë, **masat parandaluese nuk kanë qënë dhe vazhdojnë të mos jenë në nivelin e kërkuar.**

KShH-ja e sheh të nevojshme të theksojë se në zbatim të ligjit dhe në interes të luftës kundër krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti, organet kompetente, kur është e nevojshme, ushtrojnë kontrole në banesë, lokale, mund të shoqërojnë për në komisarariat, të ndalojnë ose të arrestojnë persona të veçantë. **Por arbitrariteti, fyerja e dinjitetit të personit, dhuna psikike dhe fizike janë të patolerueshme, të pajustificueshme dhe të dënueshme.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i bën thirrje organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme që **raste të tilla, të përsëritura të mos i trajtojë thjesht si shfaqje të veçuara,** por si një **fenomen që kërkon të analizohet thellë dhe në mënyrë të gjithanshme,** duke i dhënë përparësi parandalimit të tij nëpërmjet masave konkrete dhe efektive.

Në përfundim, KShH-ja e sheh të nevojshme të nënvizojë dhe t'i sugjerojë organeve përkatëse të Ministrisë së Brendshme dhe zëdhënësve të shtypit të kësaj Ministrie se në raste të denoncimit të shtetasve për kryerjen e veprave penale nga ana e punonjësve të policisë, **në deklaratat e tyre për shtyp ose në media të tregohen të përmbajtur, sidomos në çështje që kanë të bëjnë me provat, motivet, fajësinë ose pafajësinë e tyre.**

KShH-ja u rikujton edhe njëherë këtyre organeve se **organ i ndjekjes penale është vetëm organ i prokurorisë dhe organ që jep drejtësi është vetëm gjykata.**

## **9 Kufizimet kolektive të energjisë elektrike nuk janë të ligjshme**

*Tiranë, më 1 Mars 2006*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, gjatë muajit shkurt 2006, ka ndjekur me vëmendje ankesat e mjaft qytetarëve të Tiranës dhe të rretheve të tjera të vendit.

**Ka pakënaqësi të shumta jo vetëm për kufizime me orë të zgjatura të energjisë elektrike, por edhe për ndërprerje kolektive të saj** duke dëmtuar kështu edhe një numër të konsiderueshëm shtetasish **që janë të rregullt në shlyerjen e detyrimeve** kundrejt faturave gjë që vërtetohet me librezat dhe dokumentacionin përkatës.

Ndaj ankesave të mësipërme **përgjigja e drejtuesve të KESH-it se masa e kufizimeve të tilla varet nga përqindja e arkëtimeve në shkallë qyteti, bashkie apo komune nuk është e ligjshme sepse kontrata midis qytetarit dhe KESH-it është individuale** dhe jo kolektive.

**KSHH i bën thirrje KESH-it të respektojë kontratën në të gjithë treguesit e saj. Ne i bëjmë thirrje gjithashtu të gjithë shtetasve që të plotësojnë detyrimet e tyre kontraktuale.**

Vlen të përmendet se pasojat e kufizimeve të energjisë elektrike, veç të tjerave kanë ndikuar negativisht edhe në veprimtarinë e biznesit, në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit, në furnizimin normal dhe në kohë me bukë dhe ujë.

KSHH tërheq gjithashtu vëmendjen se ka patur edhe ankesa nga disa familjarë se si pasojë e luhatjeve në tensionin elektrik u janë dëmtuar ose nxjerrë jashtë përdorimit pajisjet shtëpiake elektrike si TV, kompiuter, kondicionerët, etj.

**KSHH i sugjeron KESH-it që edhe këtë problem ta shikojë me seriozitet dhe objektivitetin e duhur për të konkretizuar shkaku e vërtetë të këtyre pasojave. Ruajtja ose sigurimi i kabinave elektrike nuk është detyrë e shtetasve.** Ata mund të përgjigjen vetëm kur dëmi është shkaktuar për fajin e tyre.

Në përfundim, KSHH e shikon të nevojshëm t'u sugjerojë drejtuesve të KESH-it në qendër dhe në bazë, që me përjashtim të defekteve të paparashikuara ose të forcës madhore, të marrin masat përkatëse për një furnizim më të rregullt me energji elektrike. Në këtë drejtim do të ndihmonte shpejtimi i vendosjes së aparaturave matëse për çdo familje ose individ. *Kjo do t'i jepte fund edhe faturimeve aforfe.*

*KSHH mendon gjithashtu se pavarësisht nga vështirësitë objektive, kërkohet më tepër transparencë si edhe verifikime në vend të ankesave të shumta dhe të përditshme duke mos nënvleftësuar ato të komunave dhe fshatrave të veçantë.*

## 10. Mungesa e respektimit të të drejtave të sëmurëve mendorë në burgun e Krujës

Tiranë, më 3 Mars 2006

Në kuadër të një raundi vëzhgimesh të ndërmarra nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, më datë **28 Shkurt 2006**, një grup ekspertësh të KSHH-së realizuan një vëzhgim në Institucionin e Ekzekutimit të Dënimeve Penale Krujë. Qëllimi i vëzhgimit ishte respektimin e të drejtave të personave që vuajnë dënimin në këtë institucion dhe në veçanti të dënuarve të sëmurë.

Gjatë vëzhgimit rezultoi se në burgun e Krujës mungonin totalisht medikamentet mjekësore për të dënuarit. Në këtë institucion ndodhen **52 të dënuar të sëmurë mendorë**. Për këta të sëmurë mendorë mungonin të gjitha medikamentet për trajtimin e tyre. Gjithashtu, në këtë burg u evidentua dhe mungesa e një mjeku specialist psikiatër.

Vlen të përmendet se rasti konkret bie ndesh me **ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”** i cili në nenin 26 të tij “Shërbimi shëndetësor” parashikon që *“Shërbimi shëndetësor duhet të sigurojë furnizimin me ilaçe dhe pajisje mjekësore”*.

Gjithashtu trajtimi i të dënuarve të sëmurë në këtë institucion bie ndesh me **nenin 22, pikën 1 të Dokumentit të Kombeve të Bashkuara “Tërësia e rregullave minimum për trajtimin e të burgosurve”** i cili sanksionon se *“çdo institucion penitenciar duhet të ketë në dispozicion një mjek të kualifikuar, i cili të ketë njohuri në psikiatri”* si dhe **nenit 82, pika 2 dhe 3** e tij ku thuhet se *“të burgosurit që vuajnë nga sëmundje ose të meta të tjera mendore duhet të ekzaminohen dhe të trajtohen në institucione të specializuara, të vendosura nën një drejtim mjekësor”*. Gjatë kohës së qëndrimit të tyre në burg, këta persona duhet të jenë nën mbikqyrjen speciale të mjekut.

KSHH i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë që në përputhje me ligjin, detyrat dhe kompetencat e tyre të trajtojë me seriozitet problemin në fjalë dhe të marrë masa të menjëhershme për t'i siguruar medikamentet të sëmurëve në burgun e Krujës dhe sidomos të sëmurëve mendorë dhe atyre të paralizuar stacionarë.

## 11. Njoftim pwr shtyp

Tiranë më 15 mars 2006

Në datën 15 mars 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit në bashkëpunim me Forumin e Mendimit të Lirë dhe Qendrën e Studimeve Parlamentare organizoi tryezën e rumbullakët “Prezumimi i pafajësisë dhe roli i medias”.

Nëpërmjet kësaj tryeze u synua të tërhiqej vëmendja e medias dhe aktorëve të tjerë publikë për rëndësinë që paraqet respektimi i parimit kushtetues i prezumimit të pafajësisë për ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Të pranishëm në këtë tryezë ishin përfaqësues të ndryshëm të mediave, të institucioneve shtetërore, të shoqërisë civile, gazetarë, juristë, etj.



Nga diskutimet e pjesëmarrësve në tryezë u vu në pah rëndësia e veçantë e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe konceptimi më i drejtë i këtij parimi nga përfaqësuesit e medias. Gjithashtu, u diskutua për pasojat negative në rast të cënimit të këtij parimi.

Organizimi i kësaj tryeze synon sensibilizimin e përfaqësueve të medias lidhur me mbrojtjen e reputacionit dhe dinjitetit të njeriut në procesin e rëndësishëm të dhënies së informacionit. Respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë nuk pengon dhënien e lajmit, por vetëm kërkon përmirësimin e gjuhës së përdorur. Në këtë kuadër është e nevojshme që të përdoret një gjuhë korrekte e cila të mos çenojë lajmin si dhe të drejtat themelore që Kushtetuta ju njeh shtetasve të tij.

Nga të gjithë diskutantët u ngrit problemi i gjuhës së përdorur nga zyrtarë të administratës publike dhe kryesisht nga zyrtarët dhe funksionarët e shtetit, ku parimi i prezumimit të pafajësisë shkelet në mënyrë flagrante, pavarësisht se deri më sot numërohen raste të rralla të hapjes së dosjeve penale në përgjigje të akuzave gojore që politikanët i bëjnë njeri -tjetrit. Me këtë rast, tryeza e rrumbullakët sugjeron që neni 30 i Kushtetutës së RSH-së për prezumimin e pafajësisë të trajtohet edhe në qarqet e parlamentareve dhe funksionarëve zyrtarë.

Në diskutimet e bëra në këtë tryezë u evidentuan dhe vendimet e Gjykatës Europiane të të drejtave të njeriut dhe ato të Gjykatës Kushtetuese lidhur me rëndësinë e këtij parimi.

Kjo tryezë është vetëm fillimi i një procesi të gjatë për reformimin e dhënies së informacionit publikut në përputhje me parimet dhe të drejtat kushtetuese.

## **12. Konfliktet zgjidhen jo me dhunë por me dialog**

*Tiranë, më 16 Mars 2006*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëpërmjet ekranit televiziv, ndoqi me shqetësim dhe keqardhje të thellë **ngjarjen e dhunshme dhe të turpshme para hyrjes së Parlamentit midis Gardës së Republikës dhe deputetëve të opozitës.**

Pa hyrë aspak në detajet që provokuan këtë ngjarje, **KSHH-ja dënon veprimet e ndalimit të deputetëve të opozitës për të hyrë në ambjentet e Parlamentit. Ata janë përfaqësuesit legjitimë të popullit dhe gëzojnë imunitet parlamentar.**

KShH-ja është në dijeni të masës disiplinore që Byroja e Kuvendit ka marrë ndaj deputetit Petro Koçi duke e përjashtuar atë për 15 ditë nga punimet e seancës parlamentare. **Por kjo masë nuk nënkupton edhe ndalimin e tij për të hyrë lirisht në ambjentet e Kuvendit.**

Sipas paragrafit të fundit të pikës 2 të nenit 66 të Rregullores së Kuvendit, në rast se deputeti Petro Koçi do të tentonte të hynte në sallën e seancës plenare ose të komisioneve, masa e marrë ndaj tij mund të dyfishohej.

KShH-ja e shikon të nevojshme të theksojë gjithashtu **se sipas nenit 122 të Rregullores së Kuvendit, punonjësit e shërbimit të sigurisë në Kuvend jashtë sallës së seancave plenare, mund të veprojnë vetëm në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Byroja e Kuvendit.**

KShH-ja i bën thirrje Kuvendit dhe sidomos drejtuesve të tij, që të marrin masa përkatëse për të mos u përsëritur më ngjarje të kësaj natyre që dëmtojnë rëndë imazhin e vetë Kuvendit brenda dhe jashtë vendit.

KSHH ka bindjen se konfliktet zgjidhen vetëm me dialog dhe tolerancë në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe rregulloren e Kuvendit.

### **13. Kërcënime Ndaj të Drejtave të Njeriut në Shqipëri**

#### **Deklaratë nga Federata Ndërkombëtare e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

*Tiranë, Vienë, 17 Mars 2006.* Qeveria e re e Shqipërisë, e cila filloi mandatin në Shtator 2006 lançoi reforma rigorozë ligjore dhe institucionale për të trajtuar korrupsionin e shumëpërhapur dhe krimin e organizuar. Ndërkohë që shumë prej nismave të saj janë mirëpritur nga shoqëria civile, të tjerë ngrenë shqetësime për të drejtat e njeriut dhe vënë në dyshim përkushtimin e qeverisë ndaj sundimit të ligjit.

Në zbatim të programit të saj anti-korrupsion, qeveria në një numër rastesh ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese. Për shembull, propozoi të kufizonte imunitetin e anëtarëve të parlamentit pa ndryshuar dispozitat kushtetuese që garantojnë imunitetin, dhe të përjashtonte punësimin në administratën publike, në poste të doganave dhe tatimeve praktikisht çdo të afërm të autoriteteve që tashmë mbanin poste të larta në qeveri apo administratën publike. Për më tej, duket se një numër punonjësish shtetërorë janë pushuar nga puna pas procedurash që u mungon transparencja.

Zyrtarë të qeverisë kanë implikuar individë në korrupsion në mënyrë publike përpara se çështjet e tyre të hetoheshin dhe gjykoreshin, ndoshta duke shkelur të drejtën për t'u konsideruar i pafajshëm derisa të provoheshin si fajtorë në një gjyq të drejtë.

Gjithashtu, qeveria ka propozuar amendamente në legjislacionin mbi sekretin shtetëror, të cilat, nëse miratohen, mund të kufizojnë seriozisht aksesin ndaj informacionit me rendësi apo interes publik.

Gjithashtu, qeveria ka dështuar për të propozuar me shpejtësi ndryshime në kodin zgjedhor megjithë faktin që zgjedhjet e kohëve të fundit vazhduan të mos arrinin në lartësinë e standarteve ndërkombëtare. FNH dhe KShH nxisin qeverinë t'u përgjigjet rekomandimeve përkatëse të paraqitura nga Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Europë (OSBE).

FNH dhe KShH përshëndesin faktin që qeveria shqiptare ka përcaktuar si përparësi luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ne jemi të shqetësuar për mjetet e përdorura për të arritur synimet, disa prej të cilave shkelin përkushtimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Respektimi i kujdesshëm i atyre standarteve, si dhe bashkëpunimi transparent me shoqërinë civile, do të sigurojnë që të respektohen të drejtat e të gjithëve.

### **14. Deklaratë e pwrbashkwt**

Tiranë, më 20 Mars 2006

Fondacioni “Shoqëria e hapur për Shqipërinë” , **Soros**  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Qendra për nisma ligjore qytetare  
Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut  
Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut  
Qendra e Studimeve Parlamentare

Të drejtat dhe liritë e njeriut janë themeli i shtetit të së drejtës dhe demokracisë që duam të ndërtojmë. Shteti ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë ato. Ky parim bazohet në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Respektimi i kufijve dhe diskrecionit që përcakton Kushtetuta për aksionin politik është garanci thelbësore për respektimin e shtetit të së drejtës dhe demokracisë.

**Politikat anti-korrupsion janë inisiativa të domosdoshme të cilat mbështeten nga shoqëria civile dhe shtetasit në përgjithësi.** Këto politika janë të rëndësishme për zhvillimin e vendit, për konsolidimin e demokracisë dhe për përmbushjen e aspiratave të Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Europian. *Por duhet patur parasysh se politikat qeveritare nuk mund të çënojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Respektimi i të drejtave të njeriut në përputhje me Kushtetutën përbën një parakusht për suksesin e këtyre inisiativave.*

Aktorë të veçantë të shoqërisë civile kanë vëzhguar dhe shqyrtuar me vëmendje disa nisma ligjore qeveritare të kohëve të fundit të ndërmarra në kuadrin e politikave antikorrupsion. Objekt diskutimi dhe debati janë bërë:

- 1 Projektligji “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”;
- 2 Vendimet e Këshillit të Ministrave për shmangjen e nepotizmit në administratën publike, tatimore dhe doganore konkretisht Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 27.I.2006 “Për shmangjen e nepotizmit dhe ndikimit të pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 44, datë 27.1.2006 “Për shmangjen e nepotizmit në administratën publike”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.48, datë 27.1.2006 “Për disa shtesa në vendimin nr.205, datë 13.IV.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;
- 3 Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”;
- 4 Moratoriumi mbi mjetet e lundrimit.

Por, me shqetësim konstatojmë se këto inisiativa çënojnë të drejtat e njeriut në mënyrë të pajustificuar dhe bien ndesh me frymën dhe parashikimet e Kushtetutës. Mosrespektimi i të drejtave vë në diskutim suksesin dhe arritjen e qëllimeve të këtyre nismave.

**Organizatorët e kësaj tryeze i bëjnë thirrje autoriteteve shtetërore dhe në mënyrë të veçantë parlamentit dhe qeverisë që janë përgjegjës për inisiativat legjislative që të vlerësojmë më me kujdes respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në çdo nismë që ato ndërmarrin, pavarësisht nga objektivat dhe qëllimet e tyre të cilat janë të mirëpritura nga të gjithë.**

Shoqëria civile, në mënyrë të veçantë organizatat e të drejtave të njeriut, kanë tashmë një përvojë dhe eksperiencë të konsiderueshme në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. **Këto organizata kanë kontribuar në oponentat ligjore dhe në ekspertiza të ndryshme.**

**Në këtë kuadër e konsiderojmë të rëndësishme përfshirjen e këtyre organizatave dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit dhe diskutimit të këtyre inisiativave ligjore.** Kjo do të ishte një kontribut i vlefshëm për respektimin e parimeve kushtetuese dhe të shtetit ligjor si edhe në të njëjtën kohë për rritjen e cilësisë së këtyre inisiativave në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe forcimit të shtetit të së drejtës.

Edhe njëherë, organizatat tona shprehin angazhimin për të bashkëpunuar me autoritetet shtetërore në drejtim të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe forcimit të shtetit të së drejtës.

Gjithashtu, garantojmë vullnetin tonë për të reaguar në mënyrë konstruktive kur do të vlerësohet se ka një cënim të të drejtave kushtetuese të qytetarëve.

